

REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA E KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHENDETESIS- MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH

Njesia Org. Org. Jedinica Org Unit	09	Nr. Prot: Broj Prot: Prot. No	05-336
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	-26-	Data: Datum: Date:	20/01/2023

Prishtinë / a



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

KONTRATË PUBLIKE KORNIZË

36 MUAJ

Numri i kontratës:¹ 206-22-10970-2-2-1/C264

“Servisimi dhe Mirmbajtja e Automjetve Zyrtare te Msh-së”

Lot 2

Numri i Prokurimit: 206-22-10970-2-2-1

Numri i brendshëm: 206-22-46-221

Operatori ekonomik: **Bastri Ademi B.I. (N.T.Sh. “ EUROPA “)**

NUI: 810900747

Procredit Bank: 1189007362000185

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

MINISTRIA E SHËNDETËSISË, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

Bastri Ademi B.I., VLEZRIT FAZLIU, PRISHTINË, (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim: **Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve Zyrtare të Msh-se** me numër identifikues: 206-22-10970-2-2-1

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është që të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Ky aktivitet përfshinë Servisimin e rregullt, pjesët mekanike dhe elektrike, pjesët e karrasorise, pjesët për riparim dhe ngjyrosje. Lot 2 = 11 vetura

Nr.	Grupi
2	Loti 2

Pjesa 1: Servisimi dhe Mirëmbajtja e Automjeteve

A	SERVISIMI RREGULLT	Njesia matese	Sasia	Suzuki Grand Vitara 2.4 Benzin, viti I prodhimit 2012, kapacitetit 2393 cm3, 4 vetura	Suzuki SX4 1.6 Benzin 4X4, viti I prodhimit 2012, kapacitetit 1586 cm3, Vetura	Totali i servisimit të rregullt për të gjitha veturat (80 % e pikeve për vleresim)
				4	7	11
1	Servisimet e rregullta sipas Planit të serviseve të rregullta për çdo 10.000 km të kaluara. Të jepet çmimi total për servisimin e rregullt duke ndërruar vetëm: Vaji i motorrit Filteri i Vajit Filteri i Naftës Filteri i Ajrit Filteri i Klimës. Puna e Dorës	Komplet	1	€ 156.50	€ 141.50	298
2	Servisimet e rregullta sipas Planit të serviseve të rregullta për çdo 10,000 km të kaluara. Të jepet çmimi për identifikimin e prishjeve të mundshme, Defektazha duke kontrolluar vetëm: Sponat Frenat Dritat Rrotat Trapin e parë Trapin a mbramë	Komplet	1	€ 1.00	€ 1.00	2
3	Regllazha	Komplet	1	€ 20.00	€ 20.00	40
A - Gjithsej (1-3):						340

B	MIRËMBAJTJA DHE PJESET REZERVE	Njesia matese	Sasia	Suzuki Grand Vitara 2.4 Benzin, viti I prodhimit 2012, kapacitetit 2393 cm3, 4 vetura	Suzuki SX4 1.6 Benzin 4X4, viti I prodhimit 2012, kapacitetit 1586 cm3, Vetura	Totali i mirembajtjes dhe pjeseve rezervë për të gjitha veturat (20 % e pikeve në vlerësim
				4	7	11
1	Fellne alumini	copë	1	€ 120.00	€ 120.00	240.00
2	Fellne metalike	copë	1	€ 70.00	€ 70.00	140.00
3	Vaji i motorit	Litër	1	€ 13.00	€ 13.00	26.00
4	Filteri i Vajit	Litër	1	€ 12.00	€ 12.00	24.00
5	Filteri i Ajrit	copë	1	€ 23.00	€ 23.00	46.00
6	Filteri i Benzinës	copë	1	€ 37.00	€ 35.00	72.00
7	Filteri i klimës	copë	1	€ 13.00	€ 13.00	26.00
8	Vaj ndërruesi	Litër	1	€ 13.00	€ 13.00	26.00
9	Vaj hidrauliku	Litër	1	€ 8.00	€ 8.00	16.00
10	Vaji i frenave (Glicerina)	Litër	1	€ 6.00	€ 6.00	12.00
11	Antifrizi	Litër	1	€ 6.00	€ 6.00	12.00
12	Kamplug - lidhëse ose xhungtë (Cilinder i kamplugut në kabinë)	copë	1	€ 125.00	€ 125.00	250.00
13	Mbajtës i djathtë i motorit	copë	1	€ 65.00	€ 65.00	130.00
14	Bateri (akumulator) me amperazh sipas amperazhes që kërkohej për veturë	copë	1	€ 140.00	€ 140.00	280.00
15	Pllakat e frenimit (para)	Komplet	1	€ 85.00	€ 85.00	170.00
16	Pllakat e frenimit (prapa)	Komplet	1	€ 75.00	€ 75.00	150.00
17	Sensor para të frenave	copë	1	€ 10.00	€ 10.00	20.00
18	Sensor prapa të frenave	copë	1	€ 10.00	€ 10.00	20.00
19	Disk i frenimit përpara	copë	1	€ 95.00	€ 95.00	190.00
20	Frejtë tambur mbrapa (Dobosh i frenimit mbrapa)	copë	1	€ 70.00	€ 70.00	140.00
21	Huja e rrotes (zgjllobi - nyja)	copë	1	€ 120.00	€ 120.00	240.00
22	Gyp i frenave	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
23	Mbajtes i majtë i motorit.	copë	1	€ 65.00	€ 65.00	130.00
24	Sajlla e frenit të dorës (sajlla - litari i qeliktë)	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00

25	Cilinder i frenit te rrotes se pare	copë	1	€ 65.00	€ 65.00	130.00
26	Cilindri i frenit te rrotes se pasme	copë	1	€ 95.00	€ 95.00	190.00
27	Cilinder i pestë I frenit	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
28	Cilindri i xhundes (xhunte - lidhëse)	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
29	Vakumi i Frenimit	copë	1	€ 65.00	€ 65.00	130.00
30	Pompa e Vakumit	copë	1	€ 35.00	€ 35.00	70.00
31	Pompa e vakumit te frenimit	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
32	Mbulesë reduktori	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
33	Gome vaji (reduktor)	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
34	Cilindri i kvaqillës	copë	1	€ 135.00	€ 135.00	270.00
35	Mbajtes i nderrusit të shpejtësive 1	copë	1	€ 35.00	€ 35.00	70.00
36	Karteri i motorit (legeni i vajit)	copë	1	€ 40.00	€ 40.00	80.00
37	Koke kardani	copë	1	€ 35.00	€ 35.00	70.00
38	Kryqat e kardanit	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
39	Gome e ballanc shtangles	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
40	Gome e Pirunit te aksit	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
41	Spona shkurte	copë	1	€ 75.00	€ 75.00	150.00
42	Spona e gjate	copë	1	€ 75.00	€ 75.00	150.00
43	Spona qendrore	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
44	Pompa e vajit ne motor	copë	1	€ 25.00	€ 25.00	50.00
45	Kushineta e parë	copë	1	€ 175.00	€ 175.00	350.00
46	Kushineta e mramë	copë	1	€ 160.00	€ 160.00	320.00
47	Shtepize e kushinetes Rrot. Para	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
48	Regleri i alternatorit	copë	1	€ 65.00	€ 65.00	130.00
49	Mollza	copë	1	€ 75.00	€ 75.00	150.00
50	Mbajtes I Sponave	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
51	Gome e mbajtesit te sponave	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
52	Mollez e siperme	copë	1	€ 45.00	€ 35.00	80.00
53	Lidhese 4X4	copë	1	€ 35.00	€ 35.00	70.00
54	Lamelle e lidheses	copë	1	€ 35.00	€ 35.00	70.00
55	Bulon I lidhese 4X4	copë	1	€ 25.00	€ 25.00	50.00
56	Plastike e lidheses 4X4	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
57	Gome vaji (per nyje)	copë	1	€ 35.00	€ 35.00	70.00

58	Kushinete e nyjes	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
59	Bulon rrote	copë	1	€ 25.00	€ 25.00	50.00
60	Kanta e ujit	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
61	Kapaku i kantës se ujit	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
62	Nyja e jashtme e trapit të parë.	copë	1	€ 85.00	€ 85.00	170.00
63	Nyja e brendshme e trapit të parë.	copë	1	€ 85.00	€ 85.00	170.00
64	Riparimi i ndrruesit të shpejtësive.	copë	1	€ 150.00	€ 150.00	300.00
65	Gome vaji (per nyje)	copë	1	€ 35.00	€ 35.00	70.00
66	Nyje aksi	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
67	Ndërrimi i ndërruesit të shpejtësive (Manual)	copë	1	€ 120.00	€ 120.00	240.00
68	Ndërrimi i ndërruesit të shpejtësive (Automatik)	copë	1	€ 120.00	€ 120.00	240.00
69	Korpa (shporta)	copë	1	€ 75.00	€ 75.00	150.00
70	Drugllageri (kushinetë)	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
71	Gome federi	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
72	Federri i trapit (pilatnet) (trap - aks)	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
73	Amortizaret e pare	Komplet	1	€ 110.00	€ 110.00	220.00
74	Amortizaret e mbrapem	Komplet	1	€ 100.00	€ 100.00	200.00
75	Llamella,korpa, drugllageri	copë	1	€ 580.00	€ 580.00	1,160.00
76	Turrmarresi (Zamjaki)	copë	1	€ 120.00	€ 120.00	240.00
77	Mbajtes i Nderrusit te shpejtesive 2	copë	1	€ 65.00	€ 65.00	130.00
78	Sinkron nderrusit	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
79	Dorez nderrusi	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
80	Pirun i nderrusit	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
81	Kushinete e nderrusit	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
82	Diskat e mramë	copë	1	€ 85.00	€ 85.00	170.00
83	Piruni i anes se majtë	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
84	Piruni i anës së djathtë	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
85	Diferencial	copë	1	€ 750.00	€ 950.00	1,700.00
86	Goma vaji diferencial	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
87	Gumicat e para të pirunit	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
88	Gumicat rrethore të pirunit të parë	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
89	Piruni i mramë	copë	1	€ 95.00	€ 95.00	190.00
	Nxemsi i ndezjes	copë	1	€ 1.00	€ 1.00	2.00

90						
91	Kushinetat e alternatorit	copë	1	€ 35.00	€ 35.00	70.00
92	Rregullatori i (qetkicat) e altern.	copë	1	€ 65.00	€ 65.00	130.00
93	Diodat e alternatorit	copë	1	€ 65.00	€ 65.00	130.00
94	Stabilizatori mrapa	copë	1	€ 48.00	€ 48.00	96.00
95	Anllaseri (starteri)	copë	1	€ 110.00	€ 110.00	220.00
96	Automat anllaseri (automat starteri)	copë	1	€ 65.00	€ 65.00	130.00
97	Gumicat e trapit të parë	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
98	Bendix (dhembezor)	copë	1	€ 65.00	€ 65.00	130.00
99	Burija	copë	1	€ 20.00	€ 20.00	40.00
100	Termostati i ujit-ftohesit	copë	1	€ 85.00	€ 85.00	170.00
101	Ftohsi i motorrit(lladnjaku)	copë	1	€ 140.00	€ 140.00	280.00
102	Ventilatori i ftohesit	copë	1	€ 130.00	€ 130.00	260.00
103	Ftohsi mbrendshem (lladnjaku)	copë	1	€ 120.00	€ 120.00	240.00
104	Ventillatori i mbrendshem	copë	1	€ 122.00	€ 122.00	244.00
105	Turbina	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
106	Pompa e ujit	copë	1	€ 110.00	€ 110.00	220.00
107	Fshisat e gjamit	copë	1	€ 20.00	€ 20.00	40.00
108	Motorri i fshisave te xhamit	copë	1	€ 65.00	€ 65.00	130.00
109	Auspuhi-pjesa e perparme	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
110	Auspuhi-pjesa e mbrapme	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
111	Mbajtes gome l auspuhit	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
112	Ospuhi (Kazani)	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
113	Riparimi i Ospuhit	paushall	1	€ 30.00	€ 30.00	60.00
114	Bllokade e timonit	copë	1	€ 20.00	€ 20.00	40.00
115	Ndërrimi i akumulatorit,çmimi për 1 Amper	copë	1	€ 2.00	€ 2.00	4.00
116	Baza e filtrit te naftes , benzinës	copë	1	€ 2.00	€ 2.00	4.00
117	Gumica e trapit të mramë	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
118	Injektori	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
119	Koka e motorrit	copë	1	€ 250.00	€ 250.00	500.00
120	Testimi i kokes se motorrit	paushall	1	€ 50.00	€ 50.00	100.00
121	Gdhendja e kokes se motorrit	paushall	1	€ 50.00	€ 50.00	100.00
122	Diktoni i kokes se motorrit	copë	1	€ 95.00	€ 95.00	190.00

123	Diktoni i kapakut te motorrit	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
124	Gumica e ventililit	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
125	Ventilat qites	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
126	Ventilat thithes	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
127	Rrypi i dhembzor set	copë	1	€ 1.00	€ 1.00	2.00
128	Shtrengusi i rrypit (llageri) dhënzor	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
129	Pistoni (Klipi)	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
130	Pistoneta (Klipnjaqa)	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
131	Hilznet (riparimi l bllokut)	copë	1	€ 90.00	€ 90.00	180.00
132	Jastaku i amrozitoreve të parë	copë	1	€ 65.00	€ 65.00	130.00
133	Llageri i amortizatorëve të parë	copë	1	€ 60.00	€ 60.00	120.00
134	Radilica (boshti brrylor)	copë	1	€ 180.00	€ 180.00	360.00
135	Kushinetat e radilices (kushinetat e boshtit brrylor)	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
136	Semiringat (para mrapa) (semiringat-hermetizues)	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
137	Riparimi i mororrit (sherbimi)	paushall	1	€ 290.00	€ 290.00	580.00
138	Terheqja e automjetit prej vendit te ngarkimit deri ne servis	KM	1	€ 3.00	€ 3.00	6.00
139	Riparimi ndrimi,ballansimi rrotes	paushall	1	€ 8.00	€ 8.00	16.00
140	Sistemi i alarmit	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
141	Gumicat e amortizatoreve te mram	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
142	Brave e ndezjes	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
143	Rrote vollani	copë	1	€ 25.00	€ 25.00	50.00
144	Mbushja e Klimes	paushall	1	€ 40.00	€ 40.00	80.00
145	Kompresori i klimes	copë	1	€ 435.00	€ 435.00	870.00
146	Rrypi i klimes	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
147	Gyp i klimës	copë	1	€ 25.00	€ 25.00	50.00
148	Ftohsi i klimes	copë	1	€ 85.00	€ 85.00	170.00
149	Ventillatori i klimes	copë	1	€ 110.00	€ 110.00	220.00
150	Rrypi i servo timonit	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
151	Rrypi i alternatorit	copë	1	€ 38.00	€ 38.00	76.00
152	Zingiri i motorit	copë	1	€ 350.00	€ 350.00	700.00
153	Dhembezor i radilices (dhembezori l boshtit brrylor)	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
154	Dhembezor i brigastes (dhembezori l boshtit bregor)	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00

155	Dhemzori (Ndruesit-4x4-diferenciali)	copë	1	€ 250.00	€ 250.00	500.00
156	Ndërimi i ndërruesit të shpejtësisë(menjaqi)	copë	1	€ 120.00	€ 120.00	240.00
157	Kushineta e nderruesit (4x4-Diferenciali)	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
158	Shpaneri i jashtem I zingjirit (shpaneri-shtrenguesi I zingjirit)	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
159	Shpaneri i brendshem i zingjirit (shpaneri-shtrenguesi I zingjirit)	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
160	Shtrengusi i zingjirit	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
161	Koka e timonit	copë	1	€ 340.00	€ 340.00	680.00
162	Rele e dritave automatike	copë	1	€ 4.00	€ 4.00	8.00
163	Rregullimi I instalimit te rrymes	copë	1	€ 40.00	€ 40.00	80.00
164	Brava e deres (doreza)	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
165	Stabilizatori para	copë	1	€ 69.00	€ 69.00	138.00
166	Matsi i naftit	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
167	Pastrimi i sistemit te naftes-benzines	paushall	1	€ 25.00	€ 25.00	50.00
168	Manzheta (mbrojtes)	copë	1	€ 35.00	€ 35.00	70.00
169	Testimi i bllokut te motorit	paushall	1	€ 35.00	€ 35.00	70.00
170	Rrot rrypi	copë	1	€ 35.00	€ 35.00	70.00
171	Gyp uji	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
172	Gyp hidrauliku	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
173	Syri i farit	copë	1	€ 20.00	€ 20.00	40.00
174	Syri i farit H4	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
175	Syri i pozicionit	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
176	Syri i tregusit	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
177	Syri i shtop drites	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
178	Reketat e dritave dhe sinjaleve	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
179	Shtëpiza e boshtit të majtë të rrotës para	copë	1	€ 35.00	€ 35.00	70.00
180	Siguresa	copë	1	€ 2.00	€ 2.00	4.00
181	Automat I vajit	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
182	Kantica e ujit xhamave	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
183	Karikat e pistonave (unazat e pistonave)	copë	1	€ 80.00	€ 80.00	160.00
184	Pompa hidraulike e timonit	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
185	Shtëpiza e boshtit të djatht të rrotës para	paushall	1	€ 24.00	€ 24.00	48.00

186	Sajlla e haubes (litari I qelikte I haubes)	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
187	Shtëpiza e boshtit të majtë të rrotës prapa	copë	1	€ 35.00	€ 35.00	70.00
188	Alternatori	copë	1	€ 147.00	€ 147.00	294.00
189	Senzori i ABS	copë	1	€ 65.00	€ 65.00	130.00
190	ABS Komplet	Komplet	1	€ 70.00	€ 70.00	140.00
191	Kopjimi i çelsit	copë	1	€ 85.00	€ 85.00	170.00
192	Kodimi i çelsit	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
193	Resetim i programit te kompjuterit	paushall	1	€ 20.00	€ 20.00	40.00
194	Pompa e naftes	copë	1	€ 1.00	€ 1.00	2.00
195	Pomba e benzinës	copë	1	€ 145.00	€ 145.00	290.00
196	Shperndaresi-razvodniku	copë	1	€ 2.00	€ 2.00	4.00
197	Kandelat (kompleti)	copë	1	€ 110.00	€ 110.00	220.00
198	kabllat e kandelave -komplet	paushall	1	€ 65.00	€ 65.00	130.00
199	Sistemi I alarmit	paushall	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
200	Karburatori	copë	1	€ 2.00	N/A	2.00
201	Sajlle e rregullatorit te nxemjes	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
202	Rele e dritave automatike	copë	1	€ 2.00	€ 2.00	4.00
203	Rregullimi I instalimit te rrymes	copë	1	€ 40.00	€ 40.00	80.00
204	Stabilizatori	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
205	Brava e deres (doreza)	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
206	Uji i xhamave	Litër	1	€ 2.00	€ 2.00	4.00
207	Uji i destiluar	Litër	1	€ 2.00	€ 2.00	4.00
208	Pastrimi I sistemit te naftes-benzines	paushall	1	€ 25.00	€ 25.00	50.00
209	Testimi I bllokut te motorit	paushall	1	€ 35.00	€ 35.00	70.00
210	Larja brenda dhe jasht e automjetit	paushall	1	€ 7.00	€ 7.00	14.00
211	Vullkanizimi i gomave dhe gomave të mbrendshme	copë	1	€ 8.00	€ 8.00	16.00
212	Ballancimi I Rrotëve të Automjetit	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
213	Automati i shtopave	copë	1	€ 25.00	€ 25.00	50.00
214	Rele per siren	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
215	Rele per klim	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
216	Raketa i fshisave te xhamave	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
217	Raketa e sinjalizusve	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00

218	Raketa e Dritave	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
219	Brava e ndezjes	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
220	Shtëpiza e boshtit të djatht të rrotës prapa	copë	1	€ 55.00	€ 55.00	110.00
221	Ajër Matës	copë	1	€ 75.00	€ 75.00	150.00
222	Senzori Brrylor	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
223	Senzori Bregor	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
224	EGR ventil	copë	1	€ 120.00	€ 120.00	240.00
225	Bobina	copë	1	€ 145.00	€ 145.00	290.00
226	Lambdasonda	copë	1	€ 65.00	€ 65.00	130.00
227	Relej I pompave Dizel, Benizn	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
228	Senzori I shtypjes së ajrit	copë	1	€ 45.00	€ 45.00	90.00
229	Matësi I vajit të karterit	copë	1	€ 5.00	€ 5.00	10.00
230	Senzori I temperaturës së ujit	copë	1	€ 25.00	€ 25.00	50.00
231	Relej I nxemsave	copë	1	€ 10.00	€ 10.00	20.00
232	Kontrolluesi I ventilatorave	copë	1	€ 35.00	€ 35.00	70.00
233	Automat të rekvercit për ndërrues Automatik	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
234	Matës I ujit (nivelizues)	copë	1	€ 15.00	€ 15.00	30.00
235	Rregullator I gasit (Elektronik)	copë	1	€ 145.00	€ 145.00	290.00
B - gjithsejt (1-237) :						28,182.00

	çmimi total	çmimi total i peshuar
A - Gjithsej (1-3):	€ 340.00	272.00 €
B - gjithsejt (1-235) :	€ 28,182.00	5,636.40 €
Çmimi i Pergjithshem i peshuar (ofertat do te vleresohen ne baze te kesaj vlere). Kjo është vlere e cila do te duhet te shenohet ne Formularin e ofertes dhe do te lexohet gjate hapjes publike.		5,908.40 €

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.3 Sasi të vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorë/in këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurorinë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrimin e Planit për menaxhimin e kontratës dhe përfundon pas 36 muajsh.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë ditës nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Ministria e Shëndetësisë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve. Vlera totale indikative e kontratës (çmimi i poentuar) është **5,908.40** Euro.

Në pajtim me dispozitat e nenit 52 pika 6 të Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092LPP-së dhe nenin 56 pika 11 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, është përcaktuar limiti financiar prej 25,000.00 € si vlerë e paraparë për shfrytëzimin e kontratës.

Peshimi i artikuj-ve duhet bërë bazuar në peshën dhe në rëndësinë e kategorisë përkatëse, që do të thotë se sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë në Dosjen e Tenderit. Menaxheri i Kontratës mbetet përgjegjës që të dëshmojë në mënyrë të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të Autoritetit Kontraktues.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësisive do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veçanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;
- (g) Garancioni i ekzekutimit.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet





5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofruesin e Shërbimeve.

Nënshkrimet dhe Datat

Për Autoritetin Kontraktues,		Për Operatorin Ekonomik,	
Emri:	Berat Marmullaku	Emri:	Bastri Ademi
Pozita:	Zv. Udhëheqës i Div. te Prokurimit	Pozita:	Prokuror
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	20.01.2023	Data:	20.01.2023
Vula:		Vula:	

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **“Kontratë”** do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 **“Shërbimet”** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **“Ofrues i shërbimeve”** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **“Personeli”** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **“Çmimi i kontratës”** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **“Nënkontraktuesi”** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **“Palë”** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **“Autoriteti Kontraktues”** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **“KPK”** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **“KVK”** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguroesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguroesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertes. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njih lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit të shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë Ofruesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofruesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrin me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktivitetëve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përmbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paafësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdërisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofruesi i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai,

duke i ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrimit. Ekzekutimi i urdhrimit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tilla do të jenë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuar në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkesë me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuar.

Neni 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuar në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosisë. Autoriteti Kontraktues mund të zbresë dëmet e likuiduara nga pagesat të cilat duhet ti behen Ofruesit të Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbimë parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosisë.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosisë ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem në emër të vete Autoritetit, me një operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënie të pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë

koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kërkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosinë, dhe në këtë rast Ofruesi i shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi

i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tilla. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç është definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësojë defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Komunikimet gjatë menaxhimit të kontratës bëhen në mes menaxhereve të dy palëve kontraktuale. Për Autoritetin Kontraktues: Tahir Avdiu E-mail: tahir.avdiu@rks-gov.net Telefoni: 044664830 Për Operatorin ekonomik: Bastri Ademi E-mail: autoserviseuropa@hotmail.com Telefoni: 044 611 111
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 3,000.00 euro, me afatin e vlefshmërisë prej 37 muaj.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impiantëve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar. (c) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar (ii) e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhivë është i pakufizuar
Parimet të përgjithshme të pagesave	16	Kërkesat për pagese do të bëhen për shërbimet e performuara në baza mujore (ex post). Pagesa do të autorizohet dhe do të bëhet nga Autoriteti Kontraktues për shërbimet e performuara në baza mujore (ex post). Nuk ka pagese paraprake. Në pajtim me dispozitat e nenit 52 pika 6 të Ligjit për Prokurimin

		<p>Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092LPP-së dhe nenin 56 pika 11 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, është përcaktuar limiti financiar prej 25,000.00 € si vlerë e paraparë për shfrytëzimin e kontratës.</p> <p>Peshimi i artikuj-ve duhet bërë bazuar në peshën dhe në rëndësinë e kategorisë përkatëse, që do të thotë se sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë në Dosjen e Tenderit. Menaxheri i Kontratës mbetet përgjegjëse që të dëshmojë në mënyrë të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të Autoritetit Kontraktues.</p>
<p>Kualiteti i Kontrollit</p>	<p>i 17.1</p>	<p>Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë:</p> <p><u>Pranimi i shërbimeve të servिसimit, mirëmbajtjes dhe ndërrimi i pjesëve rezervë do behet nga komisioni i caktuar me vendim nga MSh.</u></p> <p><u>A: SERVISIMI I RREGULLT E AUTOMJETEVE</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Servisimi dhe mirëmbajtja e rregullt e automjeteve duhet të behet sipas kërkesave dhe nevojave nga zyrtërt përgjegjës të AK-së. • Në çmim duhet të llogaritet së bashku çmimi i pjesës (ÇP) dhe çmimi i shërbimit (ÇSH) për secilin furnizim/shërbim/punë që është përshkruar të Lista e çmimeve, në Pjesën A-SERVISIMI I RREGULLT E AUTOMJETEVE, oferta financiare të dosjes së tenderit. • Garancioni i pjesëve, vajit, shërbimeve lidhur me servisimin e rregullt kërkohet të jenë së paku 10,000 km. • Çmimet e dhëna janë fikse me të gjitha taksat, tatimet dhe detyrimet e aplikuara me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. <p><u>B: MIRËMBAJTJA DHE Pjesët REZERVE</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Në çmimin e pjesëve rezervë të automjeteve duhet të llogariten shpenzimet që lindin si rezultat i pjesëve mekanike, elektrike për rregullimin e automjetit. • Në çmim duhet të llogaritet së bashku çmimi i pjesës (ÇP) dhe çmimi i shërbimit (ÇSH) për secilin furnizim /shërbim/ punë që është përshkruar të Lista e çmimeve- në Pjesën B - MIRËMBAJTJA DHE Pjesët REZERVE, oferta financiare të dosjes së tenderit. • Garancioni i pjesëve mekanike dhe elektrike lidhur me ndërrimin e pjesës kërkohet të jenë së paku një vit nga data e pranim/dorëzimit të pjesës në gjendje të rregullt nga zyrtari përgjegjës në AK. • Pjesët që i ndrohen veturave duhet të jenë të reja nga prodhuesi, të jenë të ambalazuara dhe paketuara, të kenë përshkrimin në paketimin/ambalazhimin e pjesëve.

	<ul style="list-style-type: none"> • Çmimet e dhëna të jenë fikse me të gjitha taksat, tatimet dhe detyrimet e aplikuara me ligjet ne fuqi në Republikën e Kosovës. <p>Ofruesi i Shërbimeve duhet ti japë përparësi riparimeve ose mirëmbajtjes se këtyre automjeteve në raport me automjetet në pronësi të personave të tjerë juridik dhe fizik.</p> <p>Duhet te përdoren vetëm pjesë dhe materiale te prodhuesit (Genuine Manufacturer's parts). Në rast se pjesët dhe materialet e automjeteve nga prodhuesi (Genuine Manufacturer's parts) nuk janë në dispozicion, (p.sh. për automjetet e vjetra), ofruesi i shërbimeve duhet të informojë menaxherin e projektit të kontratës i cili mund të bie dakord qe te instalohen pjese standarde ekuivalente si OEM (Original Equipment Manufacturer), i cili dakordim duhet te shqyrtohet dhe miratohet nga eksperte teknik te Autoritetit Kontraktuese.</p> <p>Pjesët e vjetra/te zëvendësuara do të jetë pronë e Autoritetit kontraktues dhe do të duhet të kthehen nga Ofruesi i Shërbimeve tek Autoriteti Kontraktues së bashku me inventarët e pjesëve të zëvendësuar. Të gjitha pjesët që kërkojnë zëvendësim duhet të zëvendësohet vetëm me pjesë origjinale dhe garancioni i pjesës së zëvendësuar duhet të depozitohet tek Autoriteti Kontraktues.</p> <p>Përshkrimi i shërbimeve ndihmëse</p> <p>Orari i servisimeve do të jetë në përputhje me rekomandimet e prodhuesit të automjeteve.</p> <p>Autoriteti Kontraktues do të vë në dispozicion (të paktën 2 ditë më parë), për ofruesin e shërbimit çdo automjet për te cilin kërkohet servisi dhe mirëmbajtja e rregullt. Autoriteti Kontraktues do të përpiqet qe të vë automjetet në dispozicion për servisim dhe mirëmbajtje te rregullt në intervale të caktuar për të shmangur mbingarkesën. Megjithatë , për arsye operationale , disa automjete mund të mos jetë në dispozicion për servisimin e rregullt dhe Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar që të vë automjeteve në dispozicion .</p> <p>Ofruesi i Shërbimeve do të njoftohet nga Autoriteti kontraktues kur nevojitet servisi i rregullt i një automjeti. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për transportimin e automjetit nga lokalet e veta të lokali i operatorit ekonomik dhe për te marr atë pas përfundimit të shërbimeve .</p> <p>Në rast të defektit rrugor Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për marrjen e automjetit nga rruga dhe për transportimin e automjetit tek lokali i tij dhe pas përfundimit të shërbimeve për dorëzimin e automjetet tek AK.</p> <p>Riparimet do të përfundojnë në kohën më të shkurtër të mundshme duke përdorur, ku janë në dispozicion, pjesët që janë në magazinë te Ofruesit te Shërbimeve. Aty ku një pjesë nuk është në magazinë , ofruesi i Shërbimit do të konfirmojë me shkrim tek AK për datën kur pjesa do të jetë në dispozicion . Afatet kohore për disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit do të jetë 15 ditë pune ,</p>
--	--

		<p>(pesëmbëdhjetë ditë pune) .</p> <p>Çmimet e ofruara për servisimet e rregullta (Tabela A e Excel-it) duhet të përfshijë të gjitha aktivitetet që janë dhënë në tabelë . Numri i orëve të punës do të përfshihet në çmimin e servisimit të rregullt. Nëse gjatë servisimit të rregullt vërehet se është e nevojshme që të ndërrohet ndonjë pjesë e cila nuk është përfshirë në servisimin e rregullt ofruesi i shërbimeve duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues . Pasi që Autoriteti Kontraktues të merr njoftimin nga Ofruesi i Shërbimeve, Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve me shkrim nëse duhet të ndërroj atë pjesë apo jo . Nëse po , Ofruesi i Shërbimeve do të faturoj atë pjesë sipas çmimit të dhënë në listën e çmimeve për pjesë rezerve në tabelat B (Excel spreadsheet) .</p> <p>Çmimet e ofruara për mirëmbajtje dhe pjesë pjese rezerve (Tabela B e Excel-it) duhet të përfshijnë çmimet për pjesët rezerve plus çmimet për orë të punës . Nuk do të pranohet fatura e veçantë për punë.</p>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	20.2	Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes: Komisionit për ndërmjetësim pranë Ministrisë së Drejtësisë.
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën kompetente në Rep. e Kosovës, në pajtim me ligjin në Kosovë.

**Sigurimi për Garanci**
Guarantee Insurance

Seria | 10000532558

Për

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

Titulli Title	Servisimi dhe Mirmbajtja e Automjeteve Zyrtare te Msh-se - LOT 2		
Emri i Ofertuesit Name of the Bidder	N.T.Sh. "EUROPA "	Prej From	20.01.2023
Adresa Address	Vllezrit Fazliu	Deri To	19.02.2026
Telefon Telephone	044611111	Shuma e sigurimit Insured sum	3,000.00 €
Numri i personal / biznesit Personal / business number	810900747	Primi Premium	166.50 €
Data e lëshimit Date of issue	20.01.2023	TVSH VAT	29.97 €
Numri i prokurimit Procurement number	206-22-10970-2-2-1	Totali për pagesë Total for payment	196.47 €
Lloji i kontratës Contract type	Garanci Kontrate		

AUTORITETI KONTRAKTUES

Numri personal / biznesit Personal / business number	00000000	Vendi City	PRISHTINË
Adresa Address	ZAGREBIT , P.N.	Telefon Telephone	03820024136

Policë e sigurimit

DEKLAROJ se pohimet e bëra në këtë kërkesë për sigurim janë të plota dhe të vërteta dhe nëqoftëse ka fshehje apo shtrembërim të fakteve, unë heqë dorë nga dëmshpërblymi në rast dëmi.

Policëmbajtësi deklaron se prejardhja e fondeve është në përputhje me Ligjin nr.03/L-196 si dhe paragrafin 6 të Rregullorës Nr.X të Bankës Qëndrore të Kosovës.

Insurance Policy

I DECLARE that the allegations made in this insurance claim are complete and true and if there is concealment or distortion of the facts, I waive compensation in case of damage.

The policyholder declares that the origin of funds is in accordance with Law no.03 / L-196 as well as paragraph 6 of Regulation No. X of the Central Bank of Kosovo.

Agjenti
Prisig Online

Kompania e Sigurimeve PRISIG SH.A / Numri unik identifikues: 810842832 / Tel: +383 (0) 38 221 000

Email: info@prisig-ks.com / www.prisig-ks.com / Adresa: Rr. Eduard Lir 173 Lagjja Arbëria, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës





Lloji i Garancisë: Garanci Kontrate

Seria | 10000532558

Për

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

DUKE PASUR PARASYSH QË

N.T.Sh. "EUROPA"

(emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")

ka marrë përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull

Servisimi dhe Mirmbajtja e Automjeteve Zyrtare te Msh-se - LOT 2

të dhënë me numrin e Prokurimit

206-22-10970-2-2-1

(Nr. i referencës së prokurimit)

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci:

PËR KËTO ARSYE vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

3,000.00 €

Tre Mije e Euro

(shuma e garancisë në numra dhe në fjalë)

dhe ne marrim përsipër të ju pagujmë, me kërkesën tuaj të parë me shkrim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

- Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik për të kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo shkakton dëm të konsiderueshëm te Autoriteti kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të konsiderueshme për realizimin e kësaj kontrate; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose
- Ofertë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që kjo ofertë nuk mund të realizohet dhe pa asnjë ankesë ose argument, të gjitha shumat brenda limiteve të

3,000.00 €

(shuma e garancisë)

siç është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen arsyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës

20.01.2023

deri më

19.02.2026

Lëshuar në

Prishtinë

datë

20.01.2023

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

PRISHTINË



Kompania e Sigurimeve PRISIG SH.A. / Numri unik identifikues: 810842832 / Tel: +383 (0) 38 221 000

Email: info@prisig-ks.com / www.prisig-ks.com / Adresa: Rr. Eduard Lir 173 Lagjia Arbëria, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

